



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.12.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.12.2021, të parashtruar nga Grupi Operatorëve Ekonomik "Marisa" sh.p.k. NSHT"Viktory Com"&AEK MUNELLA sh.p.k. &ECO SWISS RECYCLING, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në zona rurale, me nr. të Prok: 632-21-8072-2-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik "Marisa" sh.p.k. NSHT"Viktory Com"&AEK MUNELLA sh.p.k. &ECO SWISS RECYCLING, e dt.19.12.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në zona rurale, me nr. të Prok: 632-21-8072-2-1-1 dhe nr. Brendshëm 632—21-130-211**, kundër **NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të , datës 14.12.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. **Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES i publikuar me datë: 14.12.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Grupi Operatorëve Ekonomik "Marisa" sh.p.k. NSHT"Viktory Com"&AEK MUNELLA sh.p.k. &ECO SWISS RECYCLING., me dt.14.12.2021, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në zona rurale, me Nr. të Prok: 632-21-8072-2-1-1, Nr. Brendshëm 632—21-130-211,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.12.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimeve se OE Berisha Com (i rekomanduar për kontratë) nuk i plotëson kriteret minimale të pjesa e makinerive përkatësisht të pika a) Automjetet transportuese (kamionët të pajisur me borheqës plugje) dhe shpërndarje të kripës deri 14 t.

Ju njoftoj se këto pretendime janë të pa bazuara sepse:

1. Kamioni i markës: Mercedes-Benz tipi: Actros 3240, me tabela të regjistrimit: 07-352-EA, ka peshë të automjetit 13480 kg ose 13.48 t pra është nën 14t, ju keni potencuar në ankesë peshën maksimale të ngarkesës së lejuar 18520 kg. – Ky kamion i plotëson kriteret minimale sipas kërkesës në FDT.
2. Kamioni i markës: Renault, tipi: Premium 340, me tabela të regjistrimit: 07-614-AU, është i pajisur me borheqës dhe me shpërndarës të kripës, kjo është dëshmuar me fotografi ku përputhen tabelat e regjistrimit marka e kamionit ngjyra etj. Pretendimi i juaj është i paqëndrueshëm për faktin se në Certifikatën e Regjistrimit të Automjetit jo gjithmonë paraqiten detalisht pjesët përbërëse të automjetit, në mungesë të përshkrimit në certifikatën e regjistrimit të automjetet, OE ka ofruar dëshmi me fotografi ku duket qartë se ky kamion plotëson kriteret minimale sipas kërkesës së FDT-ës.
3. Kamioni i markës: Scania, tipi: P112 HK 4X4, me tabela të regjistrimit: 07-749-AU, është i pajisur me borheqës dhe me shpërndarës të kripës, kjo është dëshmuar me fotografi ku përputhen tabelat e regjistrimit marka e kamionit ngjyra etj. Pretendimi i juaj është i paqëndrueshëm për faktin se në Certifikatën e Regjistrimit të Automjetit jo gjithmonë paraqiten detalisht pjesët përbërëse të automjetit, në mungesë të përshkrimit në certifikatën e regjistrimit të automjetet, OE ka ofruar dëshmi me fotografi ku duket qartë se ky kamion plotëson kriteret minimale sipas kërkesës së FDT-ës.

Tek Oferta Financiare mbetemi pranë asaj se çmimi i ofruara në vlerë prej 3€ për pozicionin 2. për pozicionin: Pastrimi nga bora dhe akulli me hedhje të kripës ose guralecave (kilometri gjatësi përfshin elementet e specifikuara në specifikimin teknike ANEKSI 1) është shumë i ulët pra është abnormalisht i ulët.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara
Arkivit të Komunës

z.Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

